



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Brot
für die Welt

RAPORT HULUMTIMI

Mungesa e aftësive dhe analiza e tregut
të punës për të rinjtë në bujqësi”



Qershor, 2020

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Donatorit "Bread for the World" (BfdW) nga Gjermania dhe zbatuar nga "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK).

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e "Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i BfdW.

PËRMBAJTJA

Abstrakt	5
Lista e figurave dhe shkurtesat	6
1. Hyrja	9
2. Qëllimet dhe objektivat e hulumtimit	10
3. Metodologjia	11
4. Punësimi i rinisë rurale	12
5. Arsimimi i rinisë rurale	17
6. Financimi i rinisë rurale	19
7. Emigracioni në zonat rurale largim jashtë vendit/emigrojnë	23
8. Konkluzionet	25
9. Rekomandimet.....	26
10. Shtojca – Pyetësori	27

Abstrakt

Kosova ende ballafaqohet me një papunësi të lartë, sidomos te popullësia e grupmoshës së re 15-24 vjeç. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizohet mungesa e aftësive dhe analiza e tregut për të rinjë nga mosha 18-24 në vendbanimet rurale në Komunën Skënderaj, Vushtri, Kamenicë, Shtime, Viti dhe Lipian. Nëse e krahasojmë tregun e punës të Kosovës me vendet Ballkanit Përendimor si dhe me vendet e Evropës Juglindore del se Kosova qëndron më keq sa i përket tregut të punës edhe te grupmosha e re e tregut të punës. Nëse i krahasojmë të hyrat dhe të dalurat nga tregu i punës në Kosovë me shtetet të tjera, del se të hyrat në treg të punës në Kosovë janë më të larta për shkak të popullësisë së moshës së re që e ka.

Përmes këtij hulumtimi do të krijohet një pasqyrë më e qartë sa i përket punësimit, arsimit, financave dhe emigracionit të të rinjëve të moshës 18-24 vjeç në vendbanimet rurale ku ka shtrirje ky hulumtim. Punësimi në baza gjinore te të rinjtë në zonat rurale në bazë të analizave të dalura nga ky hulumtim del se kemi një diskrepancë të theksuar të punësimit në disfavor të femrave, ku kemi një punësim të femrave me rreth 10 % ndërsa te meshkujt punësimi sillet rreth 26 %. Punësimi në veprimtaritë bujqësore dhe jobujqësore te të rinjtë në vendbanimet rurale është më i lartë në veprimtaritë jobujqësore me rreth 67 %, ndërsa në bujqësi me 33 %.

Si çështje tjetër që i është dhënë theks i veçantë në këtë hulumtim është edhe qështja e sigurimit të fondeve përmes granteve dhe kredive, ku në bazë të analizave rezulton se përfitimet nga grantet janë mjaftë të ulta apo me rreth 13.3 %. Si pjesë e hulumtimit është edhe emigracionit i të rinjëve në vendbanimet rurale, ku në bazë të rezultateve vëreht se është mjaftë i theksuar, ku një ndër faktorët që i shtynjë të rinjtë të emigrojnë jashtë vendit del të jetë papunësia dhe korrupsioni me rreth 26.7 %.

Nga ky hulumtim del se punësimi i të rinjëve është ende një fenomen kompleks andaj për përmirësimin e gjendjës së tregut të punës te të rinjtë duhet të krijohen politika të qëndrueshme të tregut të punës nga institucionet vendimmarrës si në nivel qendror ashtu edhe nivel lokal.

Lista e figurave dhe shkurtesat

Figura 3.1. Shtrirja e mostres sipas komunave	11
Figura 4.1. Punësimi sipas gjinisë	12
Figura 4.2. Punësimi sipas moshës	13
Figure 4.3. Punësimi sipas gjinisë dhe moshës	13
Figura 4.4 Punësimi në bujqësi dhe veprimtari jobujqësore	14
Figura 4.5 Punësimi sipas komunës	14
Figura 4.6. Pengesat për punësim të rinisë rurale	15
Figura 4.7. Statusi i të punësuarëve në bujqësi	15
Figura 4.8. Ofrimi i mundësisë për punësim në sektorin e bujqësisë dhe vendosmëria për të punuar në këtë sektor	16
Figura 4.9. Pse keni vendosë të punësoheni në bujqësi	16
Figura 4.10. Mënyrën e kërkimit për punë	17
Figura 5.1. Niveli i arsimit të përfunduar cili është	17
Figura 5.2 Niveli i arsimit të përfunduar me vështirësi të veçantë në bujqësi.....	18
Figura 5.3. Vijueshmëria në trajnime në fushën e bujqësisë	18
Figura 5.4. Trajnime profesionale të cilat janë nevojshme	19
Figura 6.1. Përkrahje financiare për vetëpunësim nga familja dhe kolegët	19
Figura 6.2. Përkrahja përmes granteve nga MBPZHR, Komunë apo te ndonjë donator tjetër	20
Figura 6.3. Efekti i granteve në rritje të kapaciteteve prodhuese dhe në vetëpunësim	20
Figura 6.4. Arsytet e refuzimit për mos përkrahje me grante	21
Figura 6.5. Orientimi i granteve në aktivitetet bujqësore dhe jobujqësore	21
Figura 6.6. Kreditë e marra gjatë vitit të fundit	22
Figura 6.7. Dhënia e kredive në bujqësi, orientimi i tyre si dhe vështërsitë e qasjes në kredi	22
Figura 7.1. Largimi i të rinjëve nga bujqësia/fshati	23
Figura 7.2. Shkaqet kryesore për largimin e të rinjëve nga bujqësia/fshati	24
Figura 7.3. Faktorët që i shtojnë të rinjtë të kërkojnë mundësi për largim jashtë vendit/emigrojnë	25

Shkurtesat

IADK - Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës

ASK – Agjensia e Statistikave të Kosovës

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

RAPORT HULUMTIMI

"Mungesa e aftësive dhe analiza e tregut të punës për të rinjtë në bujqësi"

1. Hyrje

Ky hulumtim luan një rol të rëndësishëm në krijimin e një pasqyre të qartë të rinisë në vendbanimet rurale sa i përket punësimit, arsimimit, trajnimeve, vështërsitë për tu marr me aktivitete bujqësore, përfitimet nga grantet dhe kreditë si dhe vështërsitë me të cilat ballafaohen në krijimin e qasjes në grante dhe kredi për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe jobujqësore në zonat rurale. Një fenomen tjetër që është trajtuar përmes këtij hulumtimi është edhe emigracioni, ku vërehet një emigrim i lartë i popullësisë e sidomos popullësisë së grupmoshave të reja. Për realizimin e këtij hulumtimi është zhvilluar anketa. Anketa është zhvilluar në javën e dytë të muajit qershor, 2020 dhe ka pasur shtrirje në vendbanime rurale, ku janë intervistuar 150 persona të moshës 18-24 vjeç në ekonomitë familjare në 6 komuna të Kosovës, respektivisht në komunën Skënderaj, Vushtrri, Kamenicë, Shtime, Viti, Lipjan. Përqindja e shtrirjes së mostrës në vendbanime rurale është bazuar në numrin e ekonomive familjare sipas rezultateve të dalura të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2011 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013).¹ Gjetet kyçe të këtij studimi tregojnë se të rinjtë në vendbanimet rurale sa i përket punësimit janë në një situat jo të mirë, ku del se punësimi të meshkujt është rreth 26 %, ndërsa të femrat me rreth 10 %. Sa i përket të punësuarve të të rinjëve sipas komunave, rezulton se përqindja më e madhe e të punësuarve është në komunën e Lipjanit me 29.6 %, Skënderajt me 18.5 %, Vushtrri me 14.8 %, Kamenicë me 14.8 %, Shtime me 13 % dhe në komunën e Vitit me 9.3 %. Vendosëmëria për t'u punësuar në bujqësi e të rinjëve që janë të punësuar në këtë sektor të ekonomisë rezulton të jetë 48.5 % duke theksuar se bujqësia është fitimprurëse. Përfitimi nga grantet nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Komuna apo ndonjë donator tjetër sipas të dhënave gjatë vitit 2019 ishin me rreth 13.3 %, ndërsa nuk kanë pasur përkrahje nga grantet rreth 86.7 %. Largimi i të rinjëve nga bujqësia përkatësisht fshati del se është një fenomen shqetësues, ku në bazë të analizimit të përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit del se rreth 94.7 % e të intervistuarëve janë përgjigjur se ka pasur emigrim të të rinjëve nga fshati. Ky studim bazohet në të dhëna primare të grumbulluara përmes pyetësori të strukturuar për të rinjtë të moshës 18-24 vjeçare që jetojnë në zonat rurale si dhe për këtë hulumtim janë shfrytëzuar edhe të dhëna nga burimet sekondare për të bërë një krahasim me të gjeturat e këtij raporti hulumtues, etj.

¹ Agjencia e Statistikës së Kosovës (2013). Regjistrimit të popullsisë ekonomive familjare dhe banesave, 2011, Prishtinë, Kosovë, Prill 2013

2. Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është analizimi i mungesës së aftësive dhe analizimi i tregut për të rinjtë e grupmoshës 18-24 vjeçare në zonat rurale.

Një ndër objektivat specifike të këtij hulumtimit janë si në vijim:

- Analizimi i faktorëve kyç që kufizojnë të rinjtë për qasje në tregun e punës;
- Identifikimi dhe vlerësimi i mungesës së njohurive të cilat duhet të adresohen nga mbështetja teknike dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve;
- Vështirësitë, pengesat, shkaqet e hezitimit për të rinjtë për t'u fokusuar në aktivitetet bujqësore;
- Problemet për qasje në fonde përkrahëse për gjenerim të të ardhurave dhe vetëpunësim;


Rezultatet e këtij hulumtimi do të krijojnë një pasqyrë më të qartë sa i përket të rinjve që jetojnë në zonat rurale në komunat ku ka pasur shtrirje ky hulumtim, si dhe do të shërbejë si input i rëndësishëm në hartimin e politikave dhe rekomandimet e dalura nga ky hulumtim do të ndikojnë në promovimin dhe lobimin e nevojave të tyre në fushën e punësimit, arsimit, qasja në fonde financiare qoftë në formë të granteve apo në formë të kredive si dhe në ofrimin e të dhënave për emigracionin dhe faktorët që ndikojnë në emigracion në zonat rurale.

3. Metodologjia

Për realizimin e këtij hulumtimi, janë grumbulluar të dhënat përmes pyetësorit. Pyetësori është zhvilluar dhe dizajnuar në mënyrë adekuate me objektivat kërkimore të hulumtimit të mungesës së aftësive dhe analiza e tregut për të rinjtë në zonat rurale në komunat Skënderajt, Vushtrri, Kamenicë, Shtime, Viti, Lipjan. Pyetësori është i përbërë nga pjesa e të dhënave të ekonomisë familjare në fillim, pastaj duke filluar me pjesën e punësimit, arsimit, financave si dhe pjesën e fundit të emigracionit. Anketa përbëhet nga 26 pyetje, ku secila pyetje ka nga 2-13 përgjigje alternative.

Pas grumbullimit të të dhënave nga terreni është bërë përfshirja e të dhënave në bazën e të dhënave. Para analizimit të të dhënave, është bërë pastrimi i bazës së të dhënave ndërsa analizimi i të dhënave është bërë përmes programit SPSS. Me qëllim të rritjes së cilësisë së të dhënave, anketa ka pasur dy lloj kontrole, një kontroll ka qenë në terren me pa se si po zhvillohet anketa në terren si dhe kontrolli tjetër ka qenë e përqëndruar në cilësinë e të dhënave, ku prapë nga të intervistuarit rreth 3 % e tyre janë pyetur përsëri për të dhënat e ofruara me i vlerësuar se a janë të njëjta me ato që kanë sjellë anketuesit nga terreni. Shpërndarja e mostrës është bërë varësisht prej madhësisë së popullimit respektivisht numërit të ekonomive familjare të komunave në zonat rurale. (Figura 3.1.).

Figura 3.1. Shtrirja e mostres sipas komunave




Përzgjedhja e mostrës është bërë me metodën e rastit, ku janë përzgjedhur 150 ekonomi familjare dhe nga këto ekonomi familjare është intervistuar vetëm nga një person i moshës 18-24 vjeç.

4. Punësimi i rinisë rurale

Punësimi² i rinisë në vendbanimet rural është jo i kënaqshëm, nga analizat e dalura del se punësimi te meshkujt është 26 %, ndërsa te femrat me rreth 10 %. Nëse e bëjmë një krahasim të punësimit në aspektin gjinorë kemi një diskrepancë të theksuar në disfavor të punësimit te femrat. (Figura 4.1).


Figura 4.1. Punësimi sipas gjinisë



Sa i përket punësimit sipas moshës nga 18-24 vjeç, rezultojnë se punësimi më i lartë është te personat e moshës 23 vjeç apo me rreth 8.7 %, e pasuar nga personat e moshës 24 vjeç me rreth 6 %, ndërsa personat e moshës 22, 21, 20, 19 dhe 18 marjnë pjesë në punësim me përqindje më të vogël në punësim (Figura 4.2).


² Në punësim përfshihen personat, të cilët gjatë javës referente kanë bërë ndonjë punë për pagesë, fitim ose përfitim familjar, në të holla ose në natyrë.

Figura 4.2. Punësimi sipas moshës



Në vijim është paraqitur punësimi sipas moshës dhe gjinisë përmes figurës 4.3.


Figura 4.3. Punësimi sipas gjinisë dhe moshës



Në bazë të analizave të dalura sa i përket punësimit ku më lartë është cekur se janë të punësuar 36% (26% meshkuj dhe 10% femra), është vërejtur se në veprimtaritë


bujqësore dhe jobujqësore të të rinjët në vendbanimet rurale, del se punësimi më i lartë është në veprimtaritë jobujqësore me rreth 67 %, ndërsa në bujqësi punësimi është me rreth 33 %.(Figura 4.4).

Figura 4.4 Punësimi në bujqësi dhe veprimtari jobujqësore




Në nivel të atyre të cilët janë përgjigjur gjatë anketimit të punësuar sipas komunave, rezulton se përqindja më e madhe e të punësuarëve është në komunën e Lipjanit me 29.6 %, Skënderajt me 18.5 %, Vushtrri 14.8%, Kamenicë me 14.8 %,Shtime me 13 % dhe Viti me 9.3 %. (Figura 4.5).

Figura 4.5 Punësimi sipas komunës




Në pyetjen e bërë lidhur me pengesat për punësim të rinisë në vendbanime rurale rezulton se përqindja më e madhe del se nuk janë të punësuar si rezultat se janë duke vijuar shkollim apo trajnim apo e shprehur në përqindje me rreth 59.2 %, pastaj mungesa e vendeve adekuate të punës me 18.4 %, nuk ka kërkesa për punësim 10.2 %, ndërsa shkaqet të tjera për mos punësim marrin pjesë me përqindje më të vogël. (Figura 4.6).

Figura 4.6. Penaesat për punësim të rinisë rurale




Për nga statusi i punësimit në bujqësi rinia në zonat rurale më shumë janë të punësuar në ndonje fermë tjetër apo e shprehur në përqindje me rreth 68.5 %, ndërsa të vetëpunësuar me 31.5 %. (Figura 4.7).

Figura 4.7. Statusi i të punësuarëve në bujqësi




Në pyetjen e bërë lidhur me ofrimin e mundësisë për punësim në sektorin e bujqësisë dhe vendosmëria për të punuar në këtë sektorë, del se sektori i bujqësisë mesatarisht i plotëson mundësitë për punësim apo me rreth 51.3%, pak 28%, aspak 12.7 %, si dhe shumë 8 %. (Figura 4.8).

Figura 4.8. Ofrimi i mundësisë për punësim në sektorin e bujqësisë dhe vendosmëria për të punuar në këtë sektorë




Sa i përket pyetjes se pse keni vendosë të punësoheni në bujqësi, përqindja më e madhe e të punësuarëve në bujqësi janë përgjegjur se bujqësia është lëmi fitimprurëse apo me rreth 48.5 %, e adhurojnë bujqësinë 20 %, është lehtë të investohet në bujqësi 20%, etj. (Figura 4.9).

Figura 4.9. Pse keni vendosë të punësoheni në bujqësi



Mënyra e kërkimit për punë më së shumti është bërë përmes shpalljeve në gazeta apo në internet me 23.7 %, pastaj me ndihmën e shokëve dhe familjarëve me 23 %, përmes institucioneve arsimore me rreth 13.8 %, përmes shërbimeve publike për punësim me rreth 12.5 %, nëpërmjet agjencisë private për punësim me 8.6 %, etj. (Figura 4.10).


Figura 4.10. Mënyrën e kërkimit për punë



5. Arsimi i rinisë rurale


Sa i përket arsimimi të rinisë në vendbanimet rurale ku ka pasur shtrirje anketa, del se përqindja më e madhe e të rinjëve janë me përgatitje Bachelor apo me 36.7 %, e pasuar me përgatitje të shkollës së mesme të përgjithshëm (gjimnaz – 3 ose 4 vite) me 35.3 %, pastaj me përgatitje të mesme profesionale 21.3 %, me master 2.7 % dhe me klasë 8 apo 9 me 4 %. (Figura 5.1).

Figura 5.1. Niveli i arsimit të përfunduar




Në pyetjen e bërë tek të rinjtë në zonat rurale që kanë të përfunduar arsimin në bujqësi del se 55.6 % janë me Fakultet të bujqësisë ndërsa 44.6 % kanë të përfunduar shkollën e mesme të bujqësisë. (Figura 5.2).

Figura 5.2 Niveli i arsimit të përfunduar me vështrim të veçantë në bujqësi




Në pyetjen e bërë lidhur me vijueshmerin e ndonjë trajnim në fushën e bujqësisë gjatë vitit të fundit, del se 92 % nuk kanë vijuar ndonjë trajnim në fushën e bujqësisë, ndërsa vetëm 8 % kanë vijuar trajnime. (Figura 5.3).

Figura 5.3. Vijueshmëria në trajnime në fushën e bujqësisë



Në pyetjen e bërë lidhur me trajnimet profesionale, se cilat trajnime janë më të nevojshme, nevojat në trajnim në pemëtarai me 27.7 %, në menaxhim të fermës me 26.5 %, përpunim me 19.4 %, blegtori me 11.6 %, lavërtari me 9.7 % si dhe të tjera me 5.2 %. (Figura 5.3).


Figura 5.4. Trajnime profesionale të cilat janë nevojshme



6. Financimi i rinisë rurale


Në pyetjen e bërë të të intervistuarëve lidhur me përkrahjen financiare për vetëpunësim nga familja dhe kolegët rezultojnë se përqindja më e madhe e mbështetjes financiare për të rinjtë në vetëpunësim është nga prindërit apo me rreth 82.3 %, e pasuar nga vëllezërit dhe motrat me 6.4 %, patash nga kolegët me 1.4 % nuk kanë pasur fare mbështetje me 9.9 %. (Figura 6.1).

Figura 6.1. Përkrahje financiare për vetëpunësim nga familja dhe kolegët




Sa i përket përkrahjes me grante nga MBPZHR, Komuna apo ndonjë donator tjetër, del se përkrahja me grante është mjaftë e zbehtë, apo me rreth 13.3 %, ndërsa nuk kanë pasur përkrahje 86.7 %. (Figura 6.2).

Figura 6.2. Përkrahja përmes granteve nga MBPZHR, Komunë apo të ndonjë donatori tjetër




Nga rezultatet e dalura, sa i përket efektit të granteve në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe në vetëpunësim, efekti i tyre ka qenë rreth 70% në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe në vetëpunësim, ndërsa 30 % e granteve rezulton se nuk kanë pasë efekt në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe në vetëpunësim. (Figura 6.3).

Figura 6.3. Efekti i granteve në rritje të kapaciteteve prodhuese dhe në vetëpunësim




Sa i përket arsyeve të refuzimit për mos përkrahje me grante nga MBPZHR, Komunitat apo ndonjë donator tjetër del se 50.0% të jetë si arsye konkurrenca e madhe për grante, dhe me nga 16.7 % të jetë sipërfaqja e kufizuar e pronës, problemet e bartjes së pronësisë, përzgjedhja jo meritore e përfituesve nga komisionet vlerësuese si dhe korrupsioni. (Figura 6.4).

Figura 6.4. Arsyet e refuzimit për mospërkrahje me grante




Sa i përket mbështetjes me grante, grantet më shumë janë orientuar në bujqësi apo me 73.3 %, pastaj në mekanizëm, infrastrukturë, bletari dhe depo me nga 6.7 %. (Figura 6.5).

Figura 6.5. Orientimi i granteve në aktivitetet bujqësore dhe jobujqësore




Në pyetjen e bërë se a kanë marr kredi në vitin e fundit, del se 87.3 % nuk kanë aplikuar, ndërsa 12.7 % kanë aplikuar. (Figura 6.6).

Figura 6.6. Kreditë e marra gjatë vitit të fundit



Në zonat rurale, kreditë del se janë shfrytëzuar më shumë për aktivitetet jobujqësore apo me rreth 47.4 %, pastaj në bujqësi me 36.8 %, në biznese private 10.5 % si dhe në mekanizëm bujqësor me 5.3 %. (Figura 6.7).


Figura 6.7. Dhënia e kredive në bujqësi, orientimi i tyre si dhe vështërsitë e qasjes në kredi



7. Emigracioni në zonat rurale


Në pyetjen e ngritur se a ka pasur largim të të rinjëve nga bujqësia përkatësisht fshati, rezulton se rreth 94.7 % e të intervistuarëve janë përgjigjur se ka pasur emigrim të të rinjëve nga fshati, ndërsa 5.3% janë përgjigjur se nuk ka pasur emigrim nga fshati. (Figura 7.1).

Figura 7.1. Largimi i të rinjëve nga bujqësia/fshati




Në pyetjen e bërë lidhur me shkaqet kryesore të largimit të të rinjëve del se përqindja më e lartë e largimit të të rinjëve nga bujqësia përkatsisht fshati del të jetë shkalla e ulët e përfitimeve nga bujqësia apo 28.1 %, e pasuar nga mungesa e programeve të veçanta për të rinjë me 23.3 %, pastaj mungesa e fondeve për vetëfinancim me 20.6 %, mungesa e kontratave të rregullta për shitje të produkteve me 12%, mekanizmi jo adekuat për zgjerim dhe rritje të kapaciteteve 4.9 %, mungesë e infrastrukturës ujitëse/mungesë uji 4.1 %, mungesë e sipërfaqeve tokësore për zgjerim të aktiviteteve bujqësore 1.9 %, si dhe infrastruktura rrugore jo e mirë 1.5 % si dhe mungesa e përkrahjes nga shteti, mungesë tregu, mospërkrahja nga institucionet nën 0.4%. (Figura 7.2).

Figura 7.2. Shkaqet kryesore për largimin e të rinjve nga bujqësia/fshati



Sa i përket faktorëve që i shtynjë të rinjtë të kërkojnë mundësi për largim jashtë vendit përkatësisht të emigrojnë del se papunësia dhe korrupsioni janë me 26.7 %, mungesa e perspektivës dhe kushtet e vështira për jetesë, paga shumë e ulët në sektorin privat dhe pasiguria në punë, mundësitë më të mira në vendet e destinacionit me 9.3 %, mungesa e sigurisë me 9.1 %, fonde të vogla për perkrahje të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural me 7.8 %, mungesë e kontraktimit të prodhimit bujqësor 2.1% dhe sipërfaqe të vogla të tokës për zhvillim intensiv të bujqësisë 0.8%. (Figura 7.3).

Figura 7.3. Faktorët që i shtynjë të rinjtë të kërkojnë mundësi për largim jashtë vendit/emigrojnë



8. Konkluzionet

Përmes këtij hulumtimi është arritur në një masë të konsiderueshme të plotësohet mungesa e informacioneve në aspektin e punësimit, arsimimit, financave dhe emigracionit për popullësinë e re 18-24 vjeçarë në vendbanimet rurale në komunën e Skenderajt, Vushtrrisë, Kamenicës, Shtimes, Vitisë dhe komunën e Lipjanit. Rezultatet e anketës tregojnë se punësimi është në nivel jo të kënaqshëm te të rinjtë e moshës 18-24 vjeç, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, punësimi për meshkujt është rreth 26 %, ndërsa te femrat me rreth 10 %. Komuna e cila prinë në punësim të të rinjve është Komuna e Lipjanit me rreth 29.6 % e pasuar nga komuna e Skënderajt me 18.5 %, pastaj e Vushtrrisë dhe e Kamenicës me nga 14.8 % ndërsa komuna e Shtimes dhe Vitisë rrezultojnë të kenë përqindje më të vogël të të punësuarëve apo kanë pasur punësim të rinisë nën 13 %. Trajnimet më shumë janë të nevojshme në pemëtarësi apo me rreth 27.7 % si dhe në menaxhim të fermës me 26.5 %. Në bazë të analizave të dalura po ashtu del se përfitimi përmes granteve nga MBPZHR, Komuna apo ndonjë donator tjetër del se rina në vendbanimet në zonat rurale nuk kanë pasur përkrahje të duhur. Emigracioni ka qenë dhe vazhdon të mbetet në Kosovë një fenomen shqetësues sidomos për të rinjtë, kjo vërehet edhe përmes këtij hulumtimi.

9. Rekomandimet

Duke marr për bazë sfidat me të cilat ndeshet grupmosha e re e fuqisë punëtore në tregun e punës, është e domosdoshme që të krijohen strategji të qëndrueshme nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë (MASHT), MBPZHR, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) si dhe akteret të tjerë relevant. Edhe pse ekzistojnë strategji të punësimit në nivel vendi, këto strategji nuk janë jetësuar në një masë të konsiderueshme, andaj gjatë formulimit të strategjisë së punësimit duhet t'i kushtohet një rëndësi të theksuar fazës së parë të strategjisë. Duke u bazuar në të gjeturat e këtij raporti është ardhë deri te rekomandimet që do të jenë të rëndësishme për hartuesit e politikave të punësimit në nivel vendi si dhe në nivel lokal si në vijim:

1. Krijimi i politikave të qëndrueshme të punësimit në nivel vendi për përmirësimin e tregut të punës te të rinjtë
 2. Nga niveli qendror përkatësisht Qeveria si dhe Komuna duhet të krijojnë më shumë iniciativa në zonat rurale me qëllim që të rrisin integrimin e popullësisë së grupmoshës së re në tregun e punës.
 3. Rritja e numrit të trajnimeve profesionale në fushën e bujqësisë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve teknike të të rinjëve.
 4. Marrja e masave aktive të punësimit për rininë në vendbanimet rurale përmes programe për punësim.
- Zhvillimi i hulumtimeve të rregullta vjetore me qëllim të sigurimit të informatave sa i përket treguesve të punësimit, arsimimit, finacimit, emigracionit si dhe treguesëve të tjerë që shërbejnë si input i rëndësishëm për hartimin e politikave dhe strategjive zhvillimore për tregun e punës te të rinjtë.
6. Rritja e numrit të granteve në fushën e bujqësisë nga MBPZHR si dhe institucionet të tjera me qëllim të integrit të rinjëve në punësim dhe në gjenerim të të ardhurave.
 7. Të zhvillohen edhe anketat të tjera që ndërlidhen me statistikat e tregut të punës, pasi që hartuesit e politikave dhe strategjive të tregut të punës duhet të kenë informata gjithëpërfshirëse, të freskëta dhe në kohë.
 8. Të ofrohen kredi nga bankat komerciale dhe Institucionet mikrofinanciare me kushte më të volitshme për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore me qëllim të rritjes së punësimit te të rinjtë në zonat rurale.

Aneksi. Pyetësi**ANKETA MBI ANALIZIMIN E MUNGESËS SË AFTËSIVE
DHE ANALIZËN E TREGUT PËR TË RINJË**

Përshëndetje / Mirëdita / Mirëmbreëma, Unë jam Intervistues nga IADK. Ne jemi duke zhvilluar një anketë të hulumtimit për analizimin e mungesës së aftësive dhe analizën e tregut për të rinjtë. Ekonomia e juaj familjare është zgjedhur rastësisht për anketim dhe ju jeni në mesin e 150 ekonomive familjare të cilat do të intervistohen në mesin e gjashtë komunave në Kosovë. Qëllimi i hulumtimit është mbledhja e të dhënave që do të ndihmojnë në përmirsimin e punësimit të të rinjëve dhe parandalimin e emigracionit të të rinjve në zonat rurale në Kosovë. Të dhënat e mbledhëdhura nga kjo intervistë do të jenë konfidenciale dhe do të shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllime statistikore. Kjo intervistë nuk do t'iu marrë shumë kohë. A keni ndonjë anëtar të ekonomisë familjare të moshës 18-24 vjeç, me qëllim të zhvillimit të intervistës ?

IDENTIFIKIMI I EKONOMISË

REGJIONI :: _____ |__| KOMUNA: _____ |__|__|

FSHATI: _____

EMRI DHE MBIEMRI I KRYEFAMILJARIT: _____

ADRESA: _____

NUMRI I TELEFONIT I TË INTERVISTUARIT: _____ / _____

Të dhënat e intervistuesit dhe mbikëqyrsit

Emri dhe numri i intervistuesit:	_____	□□
Emri dhe numri i mbikëqyrsit:	_____	□□
Dita/Muaji/Viti i intervistës:	_____	□□/□□/□□□□
P1.		
Gjinia: Mashkull	□	Femër..... □
P2. Sa veççar/e jeni →		
		□□
PJESA 2: PUNËSIMI		
P3. Gjatë javës së fundit (nga e hëna deri të shtunën) a keni qenë të punësuar ?		
Po.....	1 →	Kalo në P4
Jo	2 →	Kalo në P5
P4. A keni punuar në bujqësi apo në ndonjë ndërmarrje tjetër ?		
Në bujqësi	1 →	Kalo në P6
Në veprimtari të tjera	2	
P5. Përse nuk keni punuar javën e fundit ?		
Shkolla, arsimi, trajnimi.....	01	
Bankrotim, mbyllje plotësisht	02	
Sezonë jo e mirë	03	
Mot i keq	04	
Konflikt në punë, grevë.....	05	
Ditë të lira për shkak të orarit fleksibël të punës.....	06	
Pushim vjetor.....	07	
Pushim i lindjes.....	08	
Mungesa e kohës për shkak të obligimeve familjare	09	
Mungesa adekuatë e vendeve të punës	10	
Mungesa e vetëbesimit për ta kryer punën	11	
Nuk ka kërkesa për punësim në bujqësi	12	
Të tjera (Specifikojte).....	13	

P6. Statusi i juaj në punë gjatë javës (nga e hëna deri të shtunën) në bujqësi ishte:	
I vetëpunësuar	1
Në ndonjë fermë tjetër	2
P7. Orari i punës në bujqësi:	
Me orar të plotë	1
Me gjysmë orari	2
P8. Sa mendoni që lëmia e bujqësisë ofron mundësi për punësim ?	
Aspak	1
Pak	2
Mesatarisht	3
Shumë	4
P9. Pse keni vendosë të punësoheni në bujqësi ?	
E adhuroj lëminë e bujqësisë.....	1
Është fitimprurëse.....	2
Është lehtë të investohet	3
Diçka tjetër (Specifiko).....	4
P10. Mënyrën e kërkimit për punë, specifiko vetëm një të përgjigje:	
Përmes institucionit arsimor.....	1
Përmes shërbimit publik për punësim.....	2
Nëpërmjet agjencisë private për punësim.....	3
Përmes shpalljeve në gazeta apo në internet.....	4
Ia keni dërguar një aplikacion drejtpërdrejtë punëdhënësit.....	5
Me ndihmën e shokëve ose familjes.....	6
E keni gjetur pas përvojës së mëparshme në kompaninë e njëjtë.....	7
Nisja e një biznesi privat.....	8
Tjetër (Specifiko):.....	9
PJESA 3: ARSIMI	
P11 Niveli i arsimit të përfunduar cili është:	
Fillor (klasa I-V)	1
8/9-vite shkollë (klasat VI-IX)	2
I mesëm i përgjithshëm (gjimnazi – 3 ose 4 vite)	3
I mesëm profesional (2 ose 3 ose 4 vite)	4
Bachelor	5
Master	6
Doktoratura.....	7
Tjetër (Specifiko)	8

RAPORT HULUMTIMI

"Mungesa e aftësive dhe analiza e tregut të punës për të rinjtë në bujqësi"

P12 A keni të përfunduar arsimim në bujqësi ?		
Po	1. →	Kalo në P13
Jo	2	
P13 Niveli i arsimit të përfunduar në fushën e bujqësisë ?		
Shkolla e mesme e bujqësisë	1	
Fakultet i bujqësisë	2	
Studimet pasuniversitare	3	
P14 A keni vijuar ndonjë trajnim në fushën e bujqësisë gjatë vitit të fundit ?		
Po	1	
Jo	2	
P15. Cilat trajnime profesionale mendoni se janë më të nevojshme në lëminë e bujqësisë ?		
Pemëtari	1	
Lavërtari	2	
Blegtori	3	
Përpunim	4	
Menaxhim të fermës	5	
Tjetër (Specifiko)	6	
PJESA 4: FINANCAT		
P16. A keni pasur përkrahje financare për vetëpunësim nga:		
Prindërit	1	
Vëllëzerit dhe motrat	2	
Remitencat	3	
Kolegët	4	
Tjetër (Specifiko):.....	5	
P17. A keni aplikuar për grante në MBPZHR, Komunë apo te ndonjë donator tjetër ?		
Po	1→	Kalo në P18, P19
Jo	2→	Kalo në P21
P18. A ka ndikuar përkrahja nga grantet në rritje të kapaciteteve prodhuese dhe vetëpunësim ?		
Po	1→	Kalo në P20
Jo	2	

P19. Cilat kanë qenë arsyet e refuzimit për mos përkrahje me grante ?		
Konkurrenca e madhe për grante	1	
Mungesa e përgatitjes profesionale/shkollim jo adekuat	2	
Sipërfaqja e kufizuar e pronës dhe problemet e bartjes së pronësisë	3	
Përzgjedhja jo meritore e përfituesve nga komisionet vlerësuese	4	
Tjetër (<i>Specifiko</i>):.....	5	
P20. Mbështetje me grante ku është bërë ?		
Në aktivitete jobujqësore	1	
Në bujqësi	2	
Në mekanizim	3	
Në infrastrukturë	4	
Tjetër (<i>Specifiko</i>):.....	5	→
P21. A keni marrë kredi gjatë vitit të fundit ?		
Po	1	→ Kalo në P22
Jo	2	→ Kalo në P23
P22. Kredinë e marrë ku e keni orientuar ?		
Në aktivitetet jobujqësore	1	
Në bujqësi	2	
Remitencat	3	
Në mekanizim bujqësor	4	
Në infrastrukturë	5	
Tjetër (<i>Specifiko</i>):.....	6	
P23. Cila ishte vështirësia që ju nuk keni marrë kredi ?		
Kreditë e shtrenjta	1	
Kolaterali jo adekuat	2	
Kapaciteti i pamjaftueshëm financiar për ta kthyer kredinë	3	
Ndonjë vështërsi tjetër (soecifiko)	4	

PJESA 5: EMIGRACIONI
P24. A ka pasur largimin të të rinjëve nga bujqësia/fshati ?

Po	1 →	Kalo në P25
Jo	2	dhe 26

P25. Cilat janë shkaqet kryesore për largimin e të rinjëve nga bujqësia/fshati ?


Mungesa e programeve të veçanta për të rinjtë	1
Shkalla e ulët e përfitimit nga bujqësia	2
Mungesa e kontratave të rregullta për shitje të prodhimeve	3
Mekanizmi jo adekuat për zgjerim dhe rritje të kapaciteteve	4
Mungesë e fondeve për vetëfinancim	5
Mungesë e sipërfaqeve tokësore për zgjerim të aktiviteteve bujqësore ...	6
Mungesë e infrastrukturës ujtëse/mungesë uji	7
Infrastruktura rrugore jo e mirë	8
Tjetër (Specifiko):.....	9

P26. Çka mendoni se i shtynë të rinjtë të kërkojnë mundësi për largim jashtë vendit/emigrojnë ?

Mungesë e perspektivës dhe kushtet e vështira për jetesë	1
Papunësia dhe korrupsioni	2
Paga shumë të ulëta në sektorin privat dhe pasiguri në punë	3
Fonde të vogla për përkrahje të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural	4
Sipërfaqe të vogla të tokës për zhvillim intensiv të bujqësisë	5
Mungesë e kontraktimit të prodhimit bujqësor	6
Mundësi më të mira në vendet e destinacionit	7
Mungesë e sigurie	8
Tjetër (Specifiko):.....	9

Përfundimi i intervistës!

Ju faleminderit për bashkëpunim!



Ky hulumtim është realizuar në kudër të Projektit **“Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës”**, i financuar nga Donatori “Bread for the World” (BfdW) nga Gjermania dhe zbatuar nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK).

Adresa:
Sfaraçak i Ulët, Nr.11
42000 Vushtrri
Kosovë

E-mail: info@iadk.org
Tel: +383 (0) 44 777 036
+383 (0) 49 777 046
Web: www.iadk.org

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*